

LIGJ
Nr.10 110, datë 2.4.2009

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9228,DATË 29.4.2004 “PËR
KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4 “Standardet kontabël, që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare”, në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 1/1, 2 e 3 të këtij neni”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Mikrondërmarrjet, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, nuk zbatojnë, në mënyrë të detyruar, standardet kombëtare të kontabilitetit. Ato e mbajnë kontabilitetin dhe i hartojnë pasqyrat financiare sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6139, datë 17.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi